



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



RAPORT TEMATIK DHE ANALITIK QERSHOR 2012

ABUZIMI SEKSUAL NDAJ FËMIJËVE

Tiranë, Korrik 2012



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



HYRJE

Gjatë eksperiencës tre vjeçare, ALO 116 ka zhvilluar dhe ngritur kapacitetet dhe standardet në ofrimin e shërbimit, reflektuar kjo dhe në raportimet mbi problematikat e ndryshme që fëmijët raportojnë në linjë.

Duke filluar që prej këtij muaji dhe në vazhdim raporti ynë do të ketë disa ndryshime, të cilat ne besojmë se do reflektojnë më së miri punën tonë në trajtimin profesional të rasteve.

Çdo 3-muaj raporti, përpos të dhënave nga puna e përditshme e ALO 116 dhe raportimit të të dhënave nga telefonat e fëmijëve, ne do të sjellim në vëmendjen tuaj dhe do të trajtojmë një shqetësim specifik të fëmijëve, si një mënyrë për të ngritur një shqetësim publik të të drejtave të fëmijëve, por edhe për të diskutuar së bashku mënyrat më të mira për të trajtuar shqetësimet e fëmijëve.

Ky raport tematik do të njoh lexuesit më nga afër edhe me punën e këshilluesve në ALO 116, situatën e çështjes në diskutim në Shqipëri, bazuar kjo edhe në të dhëna e statistika të analizuara nga ALO 116, mënyrat dhe teknikat e përdorura nga këshilluesit për trajtimin e rasteve etj.

Në këtë raport këshilluesi-psikolog do të ketë këndin e tij, ku do të reflektojë punën e tij/saj në trajtimin profesional të rasteve në ALO 116.

Qëllimi kryesor i ALO 116 është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve, kur ata ndodhen në situatë risku dhe të sigurojë një qasje të përshtatshme që të gjithë fëmijëve t’iu garantohen më shumë shërbime në kuadër të një sistemi mbrojtës efektiv dhe parandalues.

Problematikat dhe shqetësimet e raportuara tek ALO 116 gjatë kësaj periudhe kanë qenë të larmishme. Marrëdhëniet me partnerin/en, problemet afektive, marrëdhëniet familjare, dhuna dhe abuzimi, fenomeni i bulizmit, problemet me mësuesit, problemet akademike, varësia nga substancat, problemet në përdorimin e internetit etj, janë disa nga çështjet me të cilat përballen këshilluesit pranë ALO 116.

Belioza Çoku

Menaxhere e Përgjithshme e ALO 116



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



1. KUSH ËSHTË ALO 116?

2. RAPORT TEMATIK: “Abuzimi seksual ndaj fëmijëve”

- Dhuna ndaj fëmijëve - një fenomen global social
- Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri
- Dhuna seksuale ndaj fëmijëve dhe ALO 116
- Si t’i përgjigjemi abuzimit seksual?
- KËNDI I OPERATORIT KËSHILLUES: Si është trajtuar një rast i raportuar i dhunës seksuale ndaj një fëmije nga operatori këshillues në ALO 116.

3. FËMIJËT RAPORTOJNË! Raporti analitik i rasteve dhe telefonatave në ALO 116: Qershor 2012

4. AKTIVITETE

- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, 1 qershor 2012
- ALO 116 merr pjesë në Megatek Fest



Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPËRI

116 000 – LINJA KOMBËTARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPËRI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

1. Kush është ALO 116

ALO 116 - Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë, është një shërbim telefonik kombëtar falas, që ka për qëllim të ndihmojë fëmijët kudo në Shqipëri përmes: këshillimit nëpërmjet telefonit, dhënies së informacionit dhe referimit të rasteve tek institucionet qeveritare dhe joqeveritare, që ofrojnë shërbime për fëmijët.

Shërbimi operon 24 orë në ditë, në shtatë ditë të javës. Telefonatat janë konfidenciale dhe priten me profesionalizëm nga psikologë dhe punonjës socialë të kualifikuar. ALO 116 mbështetet nga zyra UNICEF-Shqipëri dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA/DCI Shqipëri). Shërbimi bëhet i mundur falas përmes mbështetjes së kompanive celulare AMC, Vodafone, Eagle Mobile dhe operatorit fiks ALBtelecom.

MISIONI YNE

ALO 116 - Linja Kombëtare e Telefonit të Ndhmës për Fëmijët është një shërbim kombëtar këshillimi dhe referimi për fëmijët në Shqipëri. Ajo komunikon me fëmijët nëpërmjet numrave: 116 – Linja e Ndhmës për Fëmijët në Shqipëri; 116-000 Linja e Telefonit për Fëmijët e Humbur dhe 116-111 Linja Pan-Europiane e Telefonit për Fëmijët.

ALO 116 flet me fëmijët në momentet më të vështira të jetës së tyre. Ne punojmë që të mbrojmë mirëqenien e fëmijës, nëpërmjet këshillimit me telefon, referimit dhe mbrojtjes pro-aktive të të drejtave të fëmijëve. Parimet kryesore të punës sonë janë:

- ✓ Ne i përgjigjemi falas çdo telefonate të fëmijëve, 24 orë në ditë në 7 ditë të javës;
- ✓ Ne këshillojmë dhe informojmë fëmijët për çdo problem që ata kanë;
- ✓ Ne i shërbejmë të gjithë fëmijëve;
- ✓ Ne referojmë çdo rast, që kërkon zgjidhje, pranë shërbimeve publike dhe private të mbrojtjes së fëmijës;
- ✓ Ne luftojmë për të garantuar në punën tonë standardet më të larta dhe më profesionale të ofrimit të shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë;
- ✓ Ne besojmë se çdo fëmijë dhe i ri, pavarësisht moshës apo aftësisë, gëzon të drejta të barabarta dhe ai është i aftë të identifikojë dhe shprehet për problemet që e shqetësojnë;
- ✓ Ne punojmë që të bëjmë të mundur pjesmarrjen e fëmijëve;
- ✓ Ne jemi në dispozicion edhe të fëmijëve që nuk kanë telefon, nëpërmjet postës dhe komunikimit me e-mail.



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EURO PIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



ABUZIMI SEKSUAL NDAJ FËMIJËVE



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

1. Abuzimi seksual ndaj fëmijëve

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



1.1 Dhuna ndaj fëmijëve - një fenomen global social

Mbi 220 milionë fëmijë janë pre e dhunës së ushtruar ndaj tyre. Kështu thuhet në statistikat e publikuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Rezulton se çdo vit, rreth 150 milionë fëmijë, ose 14% e popullsisë së brishtë në planet janë viktimë e abuzimeve seksuale. Shtatë për qind janë viktimë të manjakëve seksualë. Shtëpia është një vend i rrezikshëm për rreth 62 milionë vajza, të cilat martohen pa mbushur të 18-at dhe që më pas dhunohen edhe nga partnerët e tyre.

“Shumë njerëz, edhe fëmijët e pranojnë dhunën si pjesë të paevitueshme të jetës”, - thuhet në “Corriere della Sera”. “Kjo dhunë e ushtruar, mund të lërë shenja të rënda psikologjike për një kohë të gjatë në jetën e këtyre fëmijëve.

Abuzimi seksual me fëmijët mund të marrë shumë forma, ndër të cilat: inçest, pornografi, prostitucion, trafikim i qenieve njerëzore, ngacmim dhe dhunë seksuale nga bashkëmoshatarët. Të gjitha këto mund t’i shkaktojnë një dëm të rëndë shëndetit mendor dhe fizik të fëmijës. Pasojat e abuzimit seksual i ndjekin fëmijët edhe në fazat e mëvonshme të jetës si të rritur – jetë që sipas përshkrimeve të viktimave, shpesh jetohe në trishtim dhe dhimbje të fshehur.

Sipas një studimi të “Child sexual abuse in Europe” (Abuzimi Seksual i Fëmijëve në Europë), vlerësohet se 10% deri në 20% e fëmijëve në Europë vazhdojnë të dhunohen seksualisht në fëmijëri. Vëmendja publike në media drejtohet shpesh drejt atij të panjohurit që fshihet, por sidoqoftë fëmijët janë më të rrezikuar nga abuzimi prej njerëzve që i rrethojnë, si për shembull anëtarë të familjes ose miq, njerëz që kujdesen për ta, deri edhe bashkëmoshatarë.

Shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual janë ndër format më të këqija të dhunës ndaj fëmijëve. Sipas UNICEF, rreth 2 milionë fëmijë përdoren në “industrinë e seksit” çdo vit. Ka më shumë se 1 milionë imazhe të 10-20 000 fëmijëve të abuzuar seksualisht të postuara në internet. Pak nga këta fëmijë janë identifikuar.

Shumica janë anonim, të braktisur dhe me shumë mundësi ende për t’u abuzuar. Nuk ka statistika në shtrirjen e abuzimit seksual të fëmijëve në Evropë, por është e mirënjohur që ka një disnivel të madh mes numrit të rasteve të raportuara dhe rasteve aktuale. Të dhënat që ne kemi tregojnë se në Evropë shumica e abuzimit seksual kundër fëmijëve është kryer në familje, nga persona afër fëmijës apo në mjedisin social të fëmijës. Të mbrosh fëmijët nga dhuna, sidomos dhuna seksuale, ka qenë një prioritet i rëndësishëm, prej shumë kohësh në Këshillin e Evropës.



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE
 116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA
 116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
 Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
 Fushave te Tenisit, Kati 2,
 Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI
 116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPËRI
 116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPËRI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
 Mobile: + 355 67 20 75 335
 E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



1.2 Dhuna ndaj fëmijëve në Shqipëri

Për sa i përket statistikave në Shqipëri mund të themi se ende nuk ekzistojnë të dhëna të sakta mbi këtë fenomen.

Raporti studimor “Dhuna Kundër Fëmijëve në Shqipëri” i publikuar nga UNICEF doli në përfundim se 13.3% e fëmijëve të intervistuar ngacmohen seksualisht nga fëmijë/nxënës të tjerë (49.4%), nga persona të tjerë (28.1%), dhe nga mësuesit (22.5%).

Nga statistikat zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë rezulton se nga viti 2002-2007 në vendin tonë kemi 222 autorë krimesh seksuale me viktime të mitur. 10% e krimeve seksuale janë kryer nga autorë në moshën nën 18 vjeç dhe vetëm në kronikat mediatike të 2009-s është folur për të paktën 30 fëmijë të mitur të dhunuar seksualisht. Karakteristikë e dukshme e këtyre autorëve-pedofilë është fakti se kanë prirje për abuzime të rënda fizike ndaj viktimës që shoqërohen me lëndime, plagosje deri në humbje jete”.

Legjislacioni në fuqi që prek çështjet e fëmijëve në vitet e fundit është pasuruar dukshëm në përputhje me standardet e mirënjohura ndërkombëtare. Qysh në vitin 1990 Shqipëria filloi të bëjë përparime të mëdha në fushën e legjislacionit: ajo ratifikoi instrumentat kryesorë ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, përfshirë dhe ato të të drejtave të fëmijëve. Këtu hyjnë Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijës, Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, Konventa kundër torturës dhe mizerive të tjera, ndëshkimeve çnjerëzore dhe trajtimin poshtërues si dhe Konventa e Hagës për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin në birësimet jashtë vendit.

Legjislacioni shqiptar e trajton dhunën seksuale ndaj fëmijëve më gjerësisht sesa dhunën fizike. Një sërë nenesh të Kodit Penal trajtojnë forma të ndryshme të dhunës seksuale.

Këtu përfshihen: marrëdhëniet seksuale, ose homoseksuale me të mitur (Neni 100); marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur (Neni 101); marrëdhëniet seksuale, ose homoseksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari (Neni 106); kryerja e veprave të turpshme me të miturit (Neni 108); shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese me të mitur (Neni 114/a.1); shpërndarja, reklamimi dhe botimi i materialeve pornografike në mjediset e të miturve (Neni 117); trafikimi i femrave të mitura për prostitucion (Neni 30), etj.

Ndëshkimet që parashikohen në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ndaj atyre që ushtrojnë dhunë seksuale kundër fëmijëve janë mjaft të detajuara. Këtu përfshihen dënime për abuzimet individuale të të miturve (nenet 10, 11, 101, 103); për abuzimet seksuale me bashkëpunim ose më shumë se një herë, dhe abuzimi seksual me dhunë (Neni 17); për format homoseksuale të dhunës ndaj të miturve (që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale (Neni 15); për marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari për organizimin dhe shfrytëzimin e prostitucionit me të mitur brenda dhe jashtë



Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shalvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPËRI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPËRI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Shqipërisë (edhe për raste kur prostitucionin e organizojnë njerëz që kanë lidhje gjaku me të miturin (Neni 22) etj. Format e ndëshkimeve që jepen janë në çdo rast burgim (Sipas rastit nga 5 deri 20 vjet burg).

Njëkohësisht me ligjin e ri për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve datë 4.11.2010, përcaktohen qartë të drejtat dhe mbrojtja që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës që garantojnë realizimin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën.

1.3 Dhuna seksuale ndaj fëmijëve dhe ALO 116

ALO 116 gjatë 3 viteve të punës së saj ka regjistruar 70 raste të abuzimit seksual, duke përfshirë këtu të gjitha format e abuzimit seksual, si inçest, pornografi, prostitucion, dhunë dhe ngacmime seksuale nga prindër, kujdestarë, mësues, bashkëmoshatarët etj. Ky numër përfaqëson vetëm majën e “Ice-berg”, duke qenë realistë se në vendin tonë, në krahasim me vendet e tjera europiane dhe SHBA, janë shumë pak rastet që denoncohen.

Këshilluesit e ALO 16 dëgjojnë fëmijët, i stimulojnë ata të flasin për këtë shqetësim duke marrë parasysh ndjenjat dhe dhimbjen e tyre.

Rastet e abuzimit seksual përbëjnë edhe rastet më të vështira për tu trajtuar në shërbimin e linjës së këshillimit për fëmijë.

Fëmijët e ngacmuar seksualisht shfaqin tërheqje dhe mungesë gatishmërie për të denoncuar abuzuesit. Ata ndihen të turpëruar dhe shpesh herë fajësojnë veten për atë çfarë ka ndodhur.

Të rriturit duhet të përpiqen të shmangin krijimin e tabuve rreth seksualitetit, dhe të sigurohen që fëmijët e dinë se kë të kontaktojnë nëse ata ndjehen të brengosur, të shqetësuar apo të trishtuar. Ju takon të rriturve të jenë të vëmendshëm dhe të kuptojnë ndjenjat dhe sjelljet e tyre. Mund të ketë gjithmonë arsye pse një fëmijë refuzon të ketë kontakt me një të rritur apo një fëmijë tjetër. Kjo dëshirë e fëmijës duhet të respektohet. Ata, gjithmonë duhet të ndjehen rehat për të folur lirshëm me prindërit e tyre mbi këtë çështje.

Në pjesën më të madhe të rasteve të raportuara në shërbimin tonë, fëmijët ndjehen të turpëruar dhe në siklet për të folur me prindërit e tyre mbi çështjet që lidhen me seksualitetin.

Më poshtë paraqiten dy tabela të cilat tregojnë rastet e dhunës dhe abuzimit të trajtuara nga ALO 116 gjatë periudhës 2009-2011.



Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Abuzim dhe dhunë	Qersh –Dhjetor, 2009	2010	Janar- Dhjetor 2011
Abuzim seksual	32	35	4
Abuzim fizik	129	155	70
Abuzim emocional	2	55	63
Neglizhim	34	55	20

Periudha	2009-2010		Janar- Dhjetor 2011	
	M	F	M	F
Gjinia Problematika				
Abuzim fizik	145	93	22	48
Seksual	3	64	0	4
Emocional	9	44	18	45
Neglizhim	28	47	9	11
Dëshmitar Dhune	23	12	0	0
Bulizmi	148	119	8	14
Dhunë në familje	97	145	2	11

Në tabelat e mësipërme, shihet qartë që numri raportimeve për abuzimin seksual është relativisht i lartë. Gjatë vitit 2011 vihet re një rënie e konsiderueshme e raportimeve për këtë formë abuzimi.

1.4 Si t'i përgjigjemi abuzimit seksual?

Abuzuesit seksualë të fëmijëve mund ta bëjnë fëmijën që të përjetojë frikë ekstreme në rast se do ta nxjerrë sekretin. Fëmija mund të flasë vetëm kur e ndjen se është i/e rrethuar nga një mjedis, i cili i beson dhe e mbështet. Nëse një fëmijë thotë së është ngacmuar, prindërit duhet të përpiqen të qëndrojnë të qetë dhe ta risigurojnë fëmijën se gjithcka çfarë ka ndodhur nuk ka qenë për faj të tij/saj.

Të rriturit mund të mos ndjehen të përgatitur dhe të mos dinë se çfarë të thonë në rast se fëmijët e tyre ju tregojnë se janë abuzuar ose ngacmuar seksualisht. Më poshtë janë listuar disa sugjerime në lidhje me atë çfarë duhet bërë në rastet kur një fëmijë thotë së është abuzuar seksualisht:



Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Çfarë duhet thënë? Nëse një fëmijë tregon në një mënyrë të mjegullt se ka ndodhur abuzimi seksual, ai duhet inkurajuar që të flasë lirshëm. Çdo koment vlerësues apo paragjykes do ta dëmtonte procesin.

- ✓ Fëmijës i duhet treguar se ju e kuptoni dhe se për ju është serioze gjithçka që ai/ajo ju thotë. Psikologët dhe psikiatrit e fëmijëve dhe adoleshentëve kanë treguar se ata të cilët dëgjohen dhe merren seriozisht nga të rriturit në momentin e rrëfimit kanë një ecure më të mirë në trajtimin e çrregullimeve që vijnë si pasojë e abuzimit.
- ✓ Fëmija duhet të marrë sigurinë, se fakti që ka treguar se çfarë ka ndodhur është gjëja e duhur. Një fëmijë që është afër me abuzuesin mund të ndjehet fajtor se ka nxjerrë sekretin. Fëmija gjithashtu mund të ndjehet i frikësuar nëse abuzuesi e ka kërcëuar në rast të nxjerrjes së sekretit.
- ✓ Fëmija duhet të dëgjojë se ajo çfarë ka ndodhur nuk është për faj të tij/saj. Shumica e fëmijëve viktimë të abuzimit seksual mendojnë se ata janë shkaktarët e tij apo e perceptojnë abuzimin si një formë ndëshkimi për një faj të vetin.
- ✓ Fëmijët kanë nevojë të ndjehen të mbështetur si dhe të sigurohen që do të merren masa që abuzimi do të ndalë.

1.5 KËNDI I OPERATORIT KËSHILLUES

Si është trajtuar një rast i raportuar i dhunës seksuale ndaj një fëmije nga operatori këshillues në ALO 116?

Në këtë pjesë të raportit çdo këshillues i linjës do të paraqesë një rast specifik dhe hapat që janë ndjekur ose po ndiqen për trajtimin e tij. Në këtë raport, rasti që është përzgjedhur nga këshilluesja për tu publikuar është rasti i një vajze e cila është ngacmuar dhe vazhdon të ngacmohet seksualisht nga babai i saj. Rasti është akoma në trajtim dhe nuk mund të konsiderohet akoma i zgjidhur. Mund të themi që ky është ndër rastet më të vështira që po trajton Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë.

Historiku i rastit.

B. është një vajzë 16 vjeçare në klasën e 10 e cila telefonon nga rrethi i Tiranës. Ajo telefonon për herë të parë në linjën e këshillimit për fëmijë për të treguar historinë e saj familjare dhe sjelljet jo normale që vajza ka vënë re këto kohët e fundit tek babai i saj.

“Ndjehem shumë e mërzhitur dhe dua të flas me dikë. Numrin tuaj ma ka dhënë psikologjia e shkollës. Meqënëse shkolla mbaroi, ajo më tha se te ky numër ju i dëgjoni fëmijët dhe i



Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPËRI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPËRI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

ndihmoni ata. Ndjem shumë keq sepse babai vjen i pirë në shtëpi dhe ka disa sjellje që nuk janë normale. Më vjen shumë turp të flas për këtë gjë”.

Gjatë bisedës, këshilluesja e mbështeti vajzën për të folur duke i shpjeguar qëllimin e shërbimit, vajza filloi të tregojë historinë e saj.

Ajo jeton në një familje shumë të varfër. Babai i saj punon me raste, ndërsa nëna është shtëpiake. Vajza ka një motër 19 vjeç e cila është e martuar dhe një vëlla 14 vjeç. Vajza tregon se me babain nuk ka pasur asnjëherë marrëdhënie të mira. Vajza e përshkruan babain e saj si një njeri të egër dhe autoritar që gjithmonë sillet keq me të tjerët.

B. tregon se kohët e fundit sjellja e babait të saj është bërë e padurueshme. Ai ka tentuar ta ngacmojë vajzën seksualisht. Vajza tregon një nga ngjarjet kur ka ndodhur ngacmimi. “Para disa ditësh unë isha vetëm me babain në shtëpi. Ai u afrua, ishte i pirë dhe filloi të më prekë. Unë u largova dhe u mbylla në dhomën tjetër derisa erdhi mami me vëllain në shtëpi”.

Vajza ndjehet shumë keq dhe tregon se këto situata janë përsëritur disa herë.

Ndërkohë nënën e përshkruan si një njeri të varur nga babai i saj dhe të bindur ndaj urdhërave. “Nëna ime nuk mund të marrë dot vendime për situatat që ndodhin në familjen tonë”. Jam përpjekur disa herë të flas me mamin por ajo është shumë e shpërqëndruar për shkak të vështirësive dhe situatave të tensionuara familjare. Babai ushtron dhunë mbi gjithë familjen. Nëna, në asnjë moment nuk e ka kuptuar situatën në të cilën ndodhem unë”.

Ajo shprehet se në rast se do mund të ia shprehë këtë gjë mamasë së bashku mund të gjëjnë mundësinë për ta raportuar në polici në qoftë se dhe nëna do të jetë dakord. Vetë vajza ka frikë se nëse do ta denoncojë vetë babain e saj, gjithë faji për shkatërrimin e familjes do bjerë mbi të.

Ndërhyrja

Për shkak të specifikës së rastit operatori këshillues vendosi një marrëdhënie besimi me telefonuesen.

U mblodh i gjithë informacioni i duhur me qëllim vlerësimin sa më objektiv të riskut ndaj të cilit është i ekspozuar vajza (historiku i abuzimit, shpeshësia e ngacmimeve, personat që janë në dijeni të ngacmimit, ku është drejtuar më përpara për ndihmë).

Vlerësim dhe analizë të rastit:

- Kush është faktori i riskut? (babai



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



- Cilët janë faktorët vulnerabël (mjedisi fizik, apo elemente të tjerë ose probleme të tjera që mund të kenë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes emocionale)
- Cilët janë faktorët mbrojtës (të afërmit, policia, linja)?

Operatori-Këshillues hetoi rreth mundësive dhe kapaciteteve që telefonuesja ka për ta raportuar rastin në polici (duke u fokusuar në marrëdhëniet me të afërmit si dhe personat e saj të besuar). Pikat e forta dhe të dobëta të vajzës.

Njëkohësisht këshilluesja u fokusua tek ndjenjat e fajit të vajzës. U fokusua tek mënyra se si ajo e perceptonte situatën në asosacion me gjendjen e saj emocionale. Fokusimi tek cdo ndjenjë dhe çdo detaj që vajza shprehu. Është punuar me konceptin që ajo ka për veten duke u perpjekur që ky koncept të jetë sa më pozitiv dhe i qëndrueshëm

Vajza u informua mbi ngacmimin dhe abuzimin seksual, pasojat në shëndetin fizik dhe mendor të rastit. Reflektim për procesin e vendimmarrjes në lidhje me denoncimin e rastit ose jo dhe pasojat dhe perfitimet e saj në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të familjes që nuk përbëjnë rrezik (si motra më e madhe e martuar, nëna).



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shalvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



FËMIJËT RAPORTOJNË Qershor 2012



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPËRI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPËRI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

2. Të dhënat mujore të telefonatave në ALO 116

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



Gjatë muajit Qershor 2012, ALO 116 ka pritur gjithsej **12,498** telefonata. Ndër to **6,565** telefonata janë kryer nga meshkuj, **2,687** kanë qënë femra dhe **3.246** telefonues nuk e kanë identifikuar gjininë e tyre.

Tematikat e telefonatave kanë qënë të ndryshme si: marrëdhënia me prindërit, problemet në shkollë, marrëdhënia me bashkëmoshatarët, probleme të duhanpirjes, marrëdhënia me partnerin/it etj. Përveç kësaj ka një numër shumë të lartë të telefonatave testuese, në të cilat bëjnë pjesë telefonatat ofenduese, talljet, vendosja e muzikës, zhurma, ose rastet kur fëmijët zhvillojnë biseda për të testuar këshilluesit ose shërbimin që linja ofron.

Bazuar në të dhënat e mbledhura, në këtë raport ne do të paraqesim një klasifikim të të dhënave cilësore dhe sasiore të telefonatave që kanë ardhur në ALO 116 gjatë muajit Qershor 2012.

2.1 Klasifikimi i përgjithshëm i telefonatave

Të dhënat e mëposhtme përfaqsojnë totalin e telefonatave të pritura nga secili operator - këshillues për muajin Qershor 2012. Tabela e mëposhtme tregon numrin e telefonatave të ndarë sipas kategorive përkatëse.

Tel. sipas Kategorive	Qershor 2012
Tel. për informacion	3532
Tel. për këshillim	224
Tel. për referim	2
Tel. të ndërprera	1347
Tel. testuese	5704
Heshtje	1689
Totali	12498




Tabela më poshtë tregon shpërndarjen e telefonatave për informacion sipas nën-kategorive përkatëse.

Telefonata për informacion	Nr. i fëmijëve
Informacion mbi linjën	624
Mbi çështje të fëmijëve/të drejtat e fëmijëve	39
Faleminderit për ndihmën	27
Telefonata përshëndetëse	267
E pa specifikuar/të tjera	2674
Totali	3532



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EURO PIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Çdo telefonatë që pritet regjistrohet në sistemin e të dhënave sasiore dhe cilësore të ANCH. Shifra e mësipërme nuk përfaqëson numrin e fëmijëve, por numrin e telefonatave që kanë marrë përgjigje nga operatorët këshillues.

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



➤ Tabela më poshtë tregon shpërndarjen e **telefonatave testuese** sipas kategorive përkatëse.


Telefonata testuese	Nr. i fëmijëve
Ofendim	147
Sharje	377
Tallje	2524
Kërcënim	4
Zhurme	299
Mbyllje	2238
Muzikë	85
Informacion	15
Abuzim dhe dhunë	0
I larguar nga shtëpia/me nevoja bazë	1
Mardhënia me partnerin	1
Abuzim me substancat	1
Probleme në shkollë	0
Marrëdhënia me familjen	1
Seksualiteti	0
Shëndeti fizik/mendor	1
Diskriminim	1
Totali	5704

Këtu paraqiten në mënyrë të detajuar telefonatat testuese, duke saktësuar mënyrat e shumëllojshme nëpërmjet të cilave fëmijët testojnë linjën. Në nivele të larta paraqitet numri i telefonatave të mbyllura dhe telefonatat tallëse. Gjithashtu, ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh që telefonojnë nga mjedise të zhurmshme.

Telefonuesit e rinj të identifikuar që kanë telefonuar gjatë këtij muaji janë **1769**. Ky numër përfaqëson fëmijët dhe të rinjtë të cilët kanë telefonuar për herë të parë në linjë. Numri i telefonatave të ardhura në ALO 116 gjatë këtij muaji ka qenë i lartë.

Grafiku më poshtë paraqet numrin e **telefonatave periodike** (raste të cilat telefonojnë në linjë në mënyrë periodike), **telefonatave permanente** (telefonues të cilët kanë krijuar varësi dhe telefonojnë në mënyrë të përsëritur dhe të vazhdueshme), **telefonuesve të rinj** (kjo kategori shpreh numrin total të fëmijëve që telefonojnë për herë të parë) dhe **telefonata të paidentifikuara**.

Tel. sipas llojit të tyre	Nr.
Tel. të reja	1769
Tel. periodike	1247
Tel. permanente	1372
Tel. të paidentifikuara	8110





Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

2.2 Analiza e të dhënave sipas rasteve të raportuara

Tabela më poshtë tregon problematikat e raportuara nga fëmijët gjatë muajit Qershor 2012.

Problematikat	Gjinia	Meshkuj	Femra
Abuzim dhe dhunë		7	9
Shfrytëzim për arsye përfitimi		1	0
Fëmijë me nevoja bazë		1	1
HIV-AIDS		0	0
Marrëdhëniet mes njëri-tjetrit		21	58
Probleme në shkollë		3	3
Çështje ligjore		0	0
Përdorim dhe abuzim me substanca		17	3
Fëmijë me aftësi të vecanta		3	2
Seksualiteti		0	7
Marrëdhëniet familjare		14	31
Shëndet mendor/psikosocial		16	20
Shëndet Fizik		1	4
Diskriminimi		1	0
Siguria në internet dhe celular		1	0
Totali		86	138

Në grafikun e mësipërm tregohet një krahasim i të dhënave midis gjinive dhe problematikave që telefonuesit raportojnë në linjë. Nga analizimi i të dhënave del se numri më i madh i telefonatave kryhet nga meshkujt ndërsa janë femrat ato që raportojnë më shumë shqetësime dhe probleme tek këshilluesit.

Siç mund të shihet nga grafiku i mëposhtëm, fëmijët përballen me një gamë të gjerë të çështjeve, shqetësimeve dhe problemeve. Një pjesë e këtyre shqetësimeve është e identifikuar nga ata dhe raportohet menjëherë tek këshilluesit, por në mjaft raste duhet ndihma e këshilluesve, të cilët me profesionalizmin e tyre dëgjojnë problemet e fëmijëve në mënyrë aktive, ndihmojnë në identifikimin e problemeve reale dhe kontribuojnë në përmirësimin e situatës apo problemit të shfaqur.



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE
 116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA
 116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
 Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
 Fushave te Tenisit, Kati 2,
 Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI
 116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI
 116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
 Mobile: + 355 67 20 75 335
 E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Implemented by:




Funded by:



Supported



AKEP



Më së shumti, shqetësimet e paraqitura nga fëmijët gjatë muajit Qershor 2012, kanë lidhje me marrëdhëniet mes tyre (marrëdhëniet me fëmijë të tjerë, marrëdhëniet me partnerin, dhe marrëdhëniet afektive), abuzimi me substancat (informacion për substancat e ndryshme dhe varësia nga substancat), marrëdhëniet në familje (marrëdhëniet prind-fëmijë, marrëdhëniet vëllazërore, kujdestaria e fëmijës, mbështetja e fëmijës), problemet në shkollë (probleme të performancës, marrëdhënia me mësuesit apo me personat të tjerë të rritur) etj.

Nga grafiku duket qartë se shqetësimet në lidhjet ndër-personale vazhdojnë të jenë në nivel raportimi të lartë ashtu si dhe problemet në lidhje me anëtarët e familjes. Gjatë këtij muaji vihet re ulje e numrit të rasteve të trajtuara, kjo si pasojë e ulje së nivelit të përgjithshëm të telefonatave.

2.3 Të dhënat e ANCH sipas klasifikimit gjinor

Grafiku i mëposhtëm tregon përqindjen e shpërndarjes së telefonatave sipas gjinisë së telefonuesve për muajin Qershor 2012. Sipas grafikut shumica e telefonuesve janë fëmijë meshkuj me 53% ndërsa femra 21%. Rreth 26 % të telefonatave fëmijët nuk e identifikojnë gjininë e tyre.

Gjatë këtij muaji mund të vemë re se numri i telefonuesve meshkuj vijon të mbetet më i lartë, ndërsa është ulur disi numri i telefonuesve femra.



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EURO PIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP





Tabela e klasifikimit sipas moshës dhe gjinisë				
Mosha \ -Gjinia	Djem	Vajza	Gjini e panjohur	TOTAL
0-6 vjeç	66	57	0	123
7-9 vjeç	181	189	1	371
10-12 vjeç	647	488	2	1137
13-15 vjeç	894	571	4	1469
16-17	341	248	2	591
18 +	430	188	0	618
Moshë e panjohur	4006	946	3237	8189
TOTALI	6565	2687	3246	12498



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

2.4 Analiza e të dhënave të ANCH sipas shpërndarjes gjeografike

Implemented by:



Funded by:




Supported



AKEP



Të dhënat e ANCH sipas shpërndarjes gjeografike të telefonatave në Shqipëri



Në grafikun më sipër tregohet shpërndarja gjeografike e telefonatave sipas qyteteve kryesore. Niveli më i lartë i numrit të telefonatave është në qytetet e mëdha si: Tiranë, Durrës, Fier, Korçë, Shkodër dhe Elbasan. Shtrirja gjeografike e telefonatave që vijnë në Linjë është nga e gjithë Shqipëria, si nga zonat urbane ashtu edhe nga zonat rurale.

Më poshtë po paraqesim shpërndarjen e kategorive të problemeve sipas rasteve të trajtuara në pesë qytetet kryesore, të cilat kanë dhe numrin më të lartë të telefonatave që vijnë në ALO 116.

Kategoritë	Qytetet	Tiranë	Fier	Durrës	Elbasan	Shkodër
Abuzim dhe dhunë		2	2	2	2	2
Shfrytëzim për arsye përfitimim		0	0	0	0	2
Fëmijë me nevoja bazë		0	1	0	0	0
HIV-AIDS		0	0	0	0	0
Marrëdhëniet mes njëri-tjetrit		15	3	10	3	6
Probleme në shkollë		2	0	0	1	0
Çështje ligjore		0	0	0	0	0
Përdorim dhe abuzim me substanca		2	4	2	1	0
Fëmijë me aftësi të veçanta		2	1	0	0	0
Seksualiteti		0	0	1	0	2
Marrëdhëniet familjare		14	8	3	1	1
Shëndet mendor/psikosocial		4	1	2	2	3
Shëndet Fizik		0	0	1	1	0
Diskriminimi		0	0	0	0	0
Përdorimi i sigurtë i internetit		0	0	0	0	0



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE
 116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA
 116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
 Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
 Fushave te Tenisit, Kati 2,
 Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI
 116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPËRI
 116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPËRI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
 Mobile: + 355 67 20 75 335
 E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Implemented by:






Funded by:



Supported



AKEP





116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE
 116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA
 116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
 Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
 Fushave te Tenisit, Kati 2,
 Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI
 116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPËRI
 116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPËRI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
 Mobile: + 355 67 20 75 335
 E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Implemented by:





Funded by:



Supported



AKEP



2.5 Referimi i rasteve në Institucionet shtetërore dhe OJF

Numri total i referimeve për mujin Qershor 2012, ka qenë 2 raste. Rasti i parë është referuar nga një zonjë, nga një qytet i Shqipërisë së mesme. Zonja në fjalë dyshon se në zonën ku ajo banon, një shtetas i huaj abuzon seksualisht me disa fëmijë të grupmoshave nga 8 deri në 12 vjec. Rasti u raportua nga ana e ALO 116 në polici, e cila mori përsipër ngritjen e një investigimi paraprak për verifikimin e të dhënave të rastit. Aktualisht po vazhdojnë hetimet.

Rasti i dytë është referuar në Kryqin e Kuq, Dega Fier. Nëna e dy fëmijëve kërkon ndihmë ekonomike, për shkak të gjendjes së vështirë në familjen e tyre.



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPERI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPERI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

3. Aktivitete

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



3.1 Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve, 1 qershor 2012



Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve - CRCA/DCI Shqipëri dhe Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë- ALO 116 u bënë pjesë e aktiviteteve të zhvilluara nga koalicioni “Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve” në 1 Qershor.

Në kuadër të ditës ndërkombëtare të fëmijëve u organizua një aktivitet festiv me pjesmarrjen e fëmijëve të shkollave të Tiranës dhe fëmijëve që frekuentojnë qendrat ditore, por kishte një pjesmarrje të kënaqshme edhe nga prindërit dhe mësuesit. Aktiviteti u zhvillua tek lulishtja përballë Presidencës, ku secila organizatë pjestare e koalicionit kishte ngritur standat për informimin e fëmijëve rreth aktiviteteve të tyre si dhe informimin e fëmijëve për të drejtat universale që fëmijët gëzojnë, kudo ku ata janë.

Gjatë aktivitetit u organizuan shumë lojra festive, animatorët socialë pikturonin fytyrat e fëmijëve më personazhet e tyre të dashura, fëmijët e komunitetit rom kënduan këngë sipas traditës së tyre të cilat elektrizuan të gjithë të pranishmit etj. Fëmijë të shumtë vizituan tavolinën informuese të CRCA/DCI dhe ALO 116 ku informoheshin rreth shërbimeve që ofron ALO 116, mënyrat se si mund ta kontaktojnë shërbimin, oraret e shërbimit.



Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE

116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA

116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
Fushave te Tenisit, Kati 2,
Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI

116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPËRI

116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPËRI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
Mobile: + 355 67 20 75 335
E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Aktivitetit zgjati 2 orë dhe stafi i ALO 116 shpërndau informacion nëpërmjet broshurave, fletepalosjeve jo vetëm për fëmijët por edhe për prindërit dhe mësuesit që ishin pjesëmarrës në aktivitet.

3.2 ALO 116 merr pjesë në Megatek Fest



Tiranë, 6 Korrik 2012 - ALO 116, Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë mori për herë të parë pjesë në eventin e organizuar nga Megatek, ‘Bëje mirë, Bëje vetë’, - Megatek Fest. ALO 116 ishte e pranishme në festime me dy stenda, pranë ‘Xhaxhi piktorit’ dhe pranë teatrit të kukullave. ALO 116, falë bashkëpunimit me Megatek, vuri në dispozicion artikujt me logon e saj së bashku me kutinë e dhurimeve.

Në standat e ALO 116, ishin vendosur materiale informuese për Linjën Kombëtare të Këshillimit për fëmijët dhe prindërit e tyre. Ndërkohë, disa publikime nga partnerët si UNICEF dhe Save the Children Shqipëri u vunë në dispozicion të vizitorëve. Këto publikime ofronin informacione rreth metodave pozitive të rritjes së fëmijëve.

Pjesmarrja e ALO 116 në Megatek Fest ishte fillesa e një bashkëpunimi ndërmjet Megatek dhe ALO 116, në mbështetje të linjës së vetme të ndihmës për fëmijë në Shqipëri. Ky bashkëpunim është një shembull për të gjitha bizneset se si të përfshihen në zërin e përgjegjshmërisë sociale, në ndihmë të kauzave që i përgjigjen interesit publik dhe veçanërisht atij të fëmijëve në Shqipëri.



116 - ALBANIAN NATIONAL CHILD HELP LINE
 116 111- PAN EUROPIAN NUMBER FOR CHILDREN IN ALBANIA
 116 000 – NATIONAL HELPLINE FOR MISSING CHILDREN

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;
 Office address: Pall. Shallvareve, Vila mbrapa
 Fushave te Tenisit, Kati 2,
 Tirana / Albania

116 - LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI
 116 111 - NUMRI PAN EUROPIAN PËR FËMIJËT NE SHQIPËRI
 116 000 – LINJA KOMBETARE PER FEMIJET E HUMBUR NE SHQIPËRI

Tel / Fax: + 355 4 2242264
 Mobile: + 355 67 20 75 335
 E-mail: alo116@crca.org.al
www.alo116.al

Implemented by:



Funded by:



Supported



AKEP



PROFILI I ALO 116 – Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët në Shqipëri

ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim pa pagesë për fëmijët 24/24 çdo ditë të javës i cili ofron:

- Dëgjim aktiv të fëmijëve;
- Këshillim psikologjik;
- Informacion për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve;
- Referim në shërbimet përkatëse sipas specifikës së rastit.

Ky shërbim përqendrohet tek fëmijët në nevojë si: fëmijët e dhunuar, abuzuar apo keqtrajtuar, fëmijët e rrugës, fëmijët që shfrytëzohen në punë, fëmijët që janë në konflikt me ligjin etj. Ky shërbim nuk përjashton as prindërit, mësuesit, edukatorët apo personat që punojnë me fëmijët dhe personat e intersuar për çështje lidhur me dhe për fëmijët.

ALO 116, si një shërbim kombëtar në ndihmë të fëmijëve, ofrohet nga CRCA/DCI Shqipëri- Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve:



ALO 116 financohet nga UNICEF:



ALO 116 mbështetet dhe ka marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione dhe kompani:

